

URDHËR
Nr. 545, datë 11.6.2013

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”,

URDHËROJ:

1. Urdhrat për dërgimin me shërbim të punonjësve të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) jashtë vendit, të lëshohen nga Drejtori Ekzekutiv i AIDA.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

3. Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Florjon Mima